

Në pajtim me nenin 25, paragrafi (1) dhe (3) dhe nenit (47), pika 1) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21) Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

V E N D I M
PËR LËSHIMIN NË QARKULLIM TË MONEDHAVE ME VLERË NOMINALE PREJ 2
DENARËVE

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim monedha me vlerë nominale prej 2 denarëve me shenjë të krijimit „2022” dhe me shenja të përcaktuara në Vendimin për emetimin dhe karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale prej 2 denarëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 202/16) dhe Vendimi për emetimin dhe për ndryshimin e karakteristikave themelore të monedhave me vlerë nominale prej 2 denarëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 149/21), duke filluar nga 1 maj i vitit 2022.

2. Monedhat me vlerë nominale prej 2 denarëve të emetuara në bazë të Vendimit për emetimin, strukturën nominale dhe karakteristikat themelore të monedhave dhe kartëmonedhave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 25/93) dhe Vendimit për emetimin dhe për karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale prej 2 denarëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 202/16) mbesin në qarkullim në operacionet e pagesave të gatshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë prej shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ven. nr. 02-15/V-4/2022
31.3.2022
Shkup

Guvernator
dhe udhëheqës
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
д-р Анита Ангеловска-Бежоска, с.р.